



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
19. DECEMBRA 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

Më 19.12.2008,

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Në bazë të Vendimit të Kuvendit nga seanca e sotme plenare, i hap punimet e seancës së re të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se kemi të paraqitur për diskutim lidhur me rendin e ditës. Ju e dini se diskutimet lidhur me rendin e ditës zgjasin nga 2 minuta.

(Reagim, prej vendi, nuk dëgjohej për transkriptim)

KRYETARI: Jo, jo, shikoni Rregulloren! Ju lutem, më i fuqishëm është Vendimi i seancës së Rregullorja. Rregulloren e voton Kuvendi. Fjalën e ka kërkuar deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Kjo mënyrë apo kjo seancë, i përngjanë, në deshi lojës së fëmijëve, në deshi mëhallëve, në katund apo kudo.

Kjo është krejtësisht e papranueshme. Zoti Kryetar i Kuvendit, dje kemi mbajtur seancën plenare dhe ky Kuvend ka votuar me arsyeshmërinë shumë të plotë për të mos u proceduar ky ligj.

Zoti Kryetar dhe zoti Kryeministër, e keni parasysh që ky shtet është shtet parlamentar, nuk është shtet presidencial, nuk është shtet i Kryeministrit të Kosovës, por është shtet parlamentar dhe ky organ është organi më i lartë i këtij vendi. Ndërsa, këtu pretendohet të vijin Ligji për Presidentin, sepse është shumë më i rëndësishëm se ai i deputetëve dhe i Kryeministrit, shumë më i rëndësishëm se ai i deputetëve dhe këta deputetë duhet t'ua votojnë juve privilegjet, në radhë të parë, sepse jeni ju më të rëndësishëm dhe jeni më të rëndësishëm ta bëni Ligjin për Presidentin e Kosovës sesa të emërohet komandanti i Forcave të Armatosura të Kosovës, të emërohet Agjencia e Inteligjencës e të emërohen shumë drejtues, të cilët vërtet janë të domosdoshëm për gjendjen aktuale çfarë është në Kosovë.

Dhe, të nderuar deputetë, ky ligj është kthyer në mandatin e kaluar, sepse ka qenë ligj për Presidentin Rugova. Dhe, ju të LDK-së i keni pasur 47 vota. Mbylle gojën! 47 vota i keni pasur dhe e keni kthyer. E vetmja unë kam qenë ajo që kam kërkuar të mos kthehet ky ligj. Ndërsa, ju keni kërkuar ta ktheni ligjin, kurse sot në shpinën e atij të ndjeri dikush do të aprovojë ligj për privilegjet e tij dhe të familjes së tij personale.

Ju lutem, të nderuar deputetë,
Ky Kuvend dhe ky popull ka gjëra shumë më të rëndësishme për të diskutuar. Dje në këtë Kuvend është kërkuar të diskutohet për sigurinë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë po ua lexoj Rregullën 22 pika 7.

(Ndërhyrje e B. Gaxherrit, pa kyçje – nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Seanca ka vendosur. Unë nuk kam vendosur.

(Vazhdon ndërhyrja)

KRYETARI: 2 minuta i ke pasur. Hajt, po bëjmë përjashtim, pasi e ka emrin Besa. Regjia ia vazhdoni edhe për 1 minutë.

BESA GAXHERRI: Zoti Kryetar!

Unë vërtet e kam emrin Besë dhe ky popull lyp besë me të votuarit e vet. Ne sot e japim edhe një shembull. I bëhet shantazh koalicionit qeverisës. Në qoftë se thotë Presidenti, nuk votohet Ligji për Presidentin, deputetët e LDK-së nuk do ta votojnë Ligjin për buxhetin e Kosovës. Kjo është para qytetarëve të Kosovës, që më e rëndësishme është të rehatoni ju veten, se sa të mendoni për qytetarët e Kosovës. Kjo është krejtësisht e papranueshme, ky është turpi dhe edhe një herë ju ftoj, të nderuar deputetë, t'i thërrisni ndërgjegjes suaj. Tek e fundit, ne jemi secili deputet dhe jemi dalë kësaj here, kemi marrë votën drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës. Në qoftë se kjo pikë e rendit të ditës kalon sot në këtë formë, ju keni përgjegjësi para të votuarit të juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë lus deputetët që kanë kërkuar fjalën, ta respektojnë kohën sipas Rregullores. Pika 22 e Rregullores, do të thotë Rregulla 22 pika 7, s'po e lexoj krejt, po e lexoj vetëm një fjali. "...Diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjatë më shumë se 2 minuta". Prandaj, fjalën e ka kërkuar, me radhë do t'ua jap dhe do ta respektoj më këtë, sepse keni të drejtë dhe unë do t'ua jap 2 minuta për të diskutuar. Në radhë është deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë kështu si deputet i ri, nuk i di rregullat, po më intereson të di diçka se a i kemi amendamentet e njëjta, apo ka ndryshuar diçka nga dje. Dua të di, a jemi të njëjtit deputetë nga dje, që votuam për tërheqje, sepse ligji nuk ishte në rregull, apo kemi deputetë tjerë këtu. A jemi të vetëdijshëm se opinioni është kah na përcjell. Ky është

degradim i plotë i Kuvendit dhe i deputetit. Unë them se nga sot Kosova nuk ka nevojë për Kuvend, kemi Qeverinë. Të paktën jo për kesi Kuvendi, se na tregon Qeveria çka duam. Unë po shoh se janë bërë transaksione në mes partive në koalicion nga dje. Është turp! Po habitem me disa deputetë nga koalicioni qeveritar, të cilët tolerojnë të luhet me personalitetin e tyre nga kushdo qoftë. Është ky turp i madh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: I nderuar Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë po habitem pak me koalicionin tuaj, po habitem më së tepërmi me PDK-në, sepse PDK-ja i thotë vetit se e mban fjalën. Kjo që ndodhi dje dhe që po ndodhë sot, është për t'u habitur. Por, mua, gjatë disa kohërave, një plak më ka pas pyetur: - Çka është politika? Cili rrenë më shumë, është më politikan! Dhe, në këtë drejtim, nuk po dihet kush është duke rrejtur më tepër dhe kjo seancë po jep të kuptohet se kush po rrenë më tepër. A më tepër po rrenë Presidenti, a Qeveria?

Por, unë do të ndalem, nën një. Ju s'keni qare pa e votuar këtë ligj. E dini ju pse s'keni qare? Sepse, Presidenti nuk ua nënshkruan Ligjin e buxhetit dhe ju, nëse nuk e votoni këtë ligj sot, ju shkon buxheti. Meqë ju shkon buxheti, duhet të votoni. Andaj, ne ju kuptojmë, jemi të arsyeshëm për t'ju kuptuar. Por, është për t'u çuditur, është për t'u çuditur ajo që po bëni ju, sepse ju keni pas thënë se jeni goxha burra dhe, po del e kundërta.

Megjithatë, unë..., ka lidhje shumë me rendin e ditës, sepse ka lidhje me miratimin e buxhetit dhe ka lidhje me miratimin e Ligjit për Presidentin dhe ju e dini që pa e miratuar Ligjin për Presidentin, s'ka buxhet. Dhe, ata që kanë qenë në Krahinën Socialiste Autonome të Jugosllavisë dhe në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë, i keni koalicion dhe e dinë të gjithë kush janë ata. Prandaj, s'ka nevojë prej vendi. Kur ta marrin, le të dalin në foltore e të flasin. Unë po ju them sinqerisht, edhe mua po më çudit kjo seancë, sepse unë nuk jam mësuar të them po e të dalë jo, të them jo, e të dalë po. Po tash, edhe Kryetari i Kuvendit, edhe Kryeministri....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Gani Geci, vërtet... Mirë, qe merre edhe një minutë, veç tepër është, a!

GANI GECI: Jo! Ndoshta është pak tepër për dikë, por unë po e them atë që po e shoh këtu. Mendoj që ju në të ardhmen do të keni kujdes, sepse vetë ata që na kanë votuar, nuk do të na tolerojnë më kështu. Nuk do të na tolerojnë më kështu sepse vjet, unë nuk kam qenë në proces, nuk kam qenë në Kuvendin e Kosovës, por ju e keni stopuar një ligj që ka pasur të bëjë me Presidentin Rugova dhe me Memorialin e Presidentit Rugova. Andaj, sot mundeni ju... Juve që po flisni prej vendi, shkoni atje te Tita, se Titon e keni pasur kumbar. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ministre!

(Ndërhyrje e ministres Nekibe Kelmendi nga vendi, pa kyçje – nuk kuptohet për transkriptim)

KRYETARI: Regjia, fjalën ia mundësoni ministres, në emër të zëvendëskryeministrit Rama.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Pa dashur ta arsyetoj veten, nuk kam qenë kurrë as në Lidhjen Komuniste, as në Lidhjen Socialiste.

(Ndërhyrje e G. Gecit – nuk dëgjohet për transkriptim)

MINISTRJA: Të lutem, më lejo të flas! Kurrë s’kam qenë as deputete në asnjë parlament të kaluar, as hiq. Përkundrazi, axhën ma kanë pushkatuar komunistët më 13 dhjetor 1945 dhe e kanë konfiskuar krejt pasurinë dhe kam qenë familje armike për atë regjim. E kush ka punuar me komunist, le ta gjejnë vetë.

KRYETARI: Po, hajt, pasi foli kjo, fol edhe ti Gani!

GANI GECI: Ju lutem, zonja ministre! Unë juve nuk ua përmenda emrin. Fjala e urtë e popullit thotë: “Kush përgjigjet, ai që e ka mizën ndër kapuç”! Unë nuk ta përmenda emrin ty dhe nuk thashë asgjë për ty. Ndoshta ju, e dashur ministre, keni qenë në Krahinën Socialiste kryetare e Gjykatës Supreme. Tash po ta përmendi emrin dhe ju i keni maltretuar të gjithë shqiptarët bashkë me ata të tjerët që kanë qenë në Jugosllavi dhe jua keni marrë paratë dhe keni ndërtuar shtëpia, kur s’ka pasur askush. Po ta them tash...

KRYETARI: Deputet Geci, ju lutem!

GANI GECI: Tash po ta them. Ju, kur kanë pas ardhur forcat serbe, nuk kanë vetë këtu, s’e kanë ditur kë e kanë kumbar, e kë e kanë armik.

(Ndërhyrje e ministres N. Kelmendi, nuk dëgjohet për transkriptim).

KRYETARI: Ministre, ju lutem! Ju lutem!

(Ndërhyrje e G. Gecit – nuk dëgjohet për transkriptim)

(Ndërhyrje e ministres N. Kelmendi, nuk dëgjohet për transkriptim)

(Ndërprerje e shkurtër nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka shefi i Grupit të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, kjo seancë po udhëhiqet në mënyrë jo të drejtë për vetë faktin se është një rregull që shifat e grupeve duhet të prononcohen të parët dhe të shprehin edhe qëndrimet e

grupeve parlamentare. Por, sido që të jetë, është shqetësim i gjithë deputetëve për atë çka ka ndodhur sot këtu. Dhe, ajo çka është kah ndodh sot këtu, dëshmon më së miri se ky Kuvend i Kosovës është shndërruar në vegël vazale të individëve apo të grupeve që tentojnë me çdo kusht ta ngufasin funksionimin e organit më të lartë legjislativ.

Ajo çka sot po ndodh këtu dhe ajo çka ka ndodhur dje në seancën plenare, nuk mund të quhet ndryshe përpos korrupsion politik. Kur themi kështu, i kemi për bazë qëndrimet tona, të cilat i kemi deklaruar të paktën publikisht dhe kemi për bazë atë se cili është interesi i përgjithshëm.

Kuvendi i Kosovës është degraduar aq shumë me seancën e sotme, sa lirisht mund ta krahasojmë me një këshill të bashkësisë lokale, që është shumë më serioz kur debatohen raste të tilla.

Ky Kuvend s'po gjend kohë të debatojë, kur cenohet sovraniteti i vendit. Ky Kuvend s'po gjend kohë të debatojë..., ata të cilët po e ngufasin shtetin e Kosovës. Ky Kuvend nuk po gjend kohë edhe për ato raste të cilat janë jetike për interesin e vendit, për organizimin e brendshëm, për politikën e jashtme, por sot Kuvendi po gjen kohë të debatojë për privilegje të individëve të caktuar. Dhe sot, të gjithë ata qytetarët të cilët mendojnë se Kuvendi i Kosovës po i mbron interesat e qytetarëve të vendit, atëherë me plotë gojë dhe përgjegjësi po deklarojmë se ky Kuvend po i mbron interesat e individëve, të grupeve dhe të klaneve të caktuara.

Si Grup Parlamentar i LDD-së nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, e ke kryer! Faleminderit! Ju lutem! Keni qenë tre deputetë prej një Grupi Parlamentar, dyve ua kam zgjatur kohën, ti je i treti dhe u krye!

(Ndërhyrje)

Jo, unë dua t'i them 3-4 fjalë.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit nga regjia)

I nderuari deputet dhe deputetë të opozitës,
Sa i përket kërkesës tuaj të djeshme, dua t'ju them se për këtë është Rregullorja e Punës të Kuvendit dhe dihet se kërkesat bëhen me shkrim dhe bëhen në emër të grupeve parlamentare. Deputetët që kanë kërkuar dje të futet një pikë e rendit të ditës si emergjente, është dashur njëherë të bisedojnë me grupet e tyre politike, të merren vesh në radhët e grupeve politike, t'i bëjnë kërkesat me shkrim, të procedohen siç procedohen kërkesat dhe, natyrisht, unë si Kryetar, Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare vendosin për një çështje a të hyjë në rend dite, a jo.

Kërkesat tuaja të djeshme kanë qenë për të bërë fjalë, edhe individuale, dhe për t'u dukur para opinionit. Nëse doni si grupe parlamentare t'i shfrytëzoni të drejtat tuaja, shfrytëzoni të drejtat që ua jep Rregullorja! Ju, deri sot, që një vit gati po bëhet, asnjëherë, siç e thotë Rregullorja e Punës, nuk keni bërë kërkesë. Prandaj, kërkesa dhe lutja ime është: krijoni marrëdhënie të rregullta në grupet parlamentare, bëni kërkesat me shkrim dhe ne përgjigjemi mbi bazën e së drejtës tuaj që ua jep Rregullorja e Punës së Kuvendit. Prandaj, për këtë edhe dola t'ju them – bëni kërkesat me shkrim, mësoni të shkruani dhe ne i procedojmë dhe e bëjmë rendin e ditës mbi bazën e kërkesave tuaja. Ju faleminderit shumë!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më duhet të them se ky ligj që sot ka hyrë në këtë formë në rend dite, tregon se edhe dje ka mund diçka të hyjë në rend dite. Sa për këtë të fundit, e për tjerat, mendoj se po i jepet një shije e keqe shumë edhe institucionit të Presidentit, edhe ligjit i cili po miratohet. Ne po bëjmë ligj për kreun e shtetit sot dhe po krijohet përshtypja se jemi duke bërë ligj për individ. Arsyeja është se janë bërë pazarllëqe politike dhe sot na vjen ligji neve në këtë mënyrë, në mënyrë totalisht të padenjë për institucionin e Presidentit.

Pa marrë parasysh çfarë është ligji, kjo mënyrë e punës është realisht përdhosje e institucioneve të Kosovës, jo vetëm e Kuvendit, i cili është mësuar vetëm me këtë mënyrë, por tani edhe e Presidencës. Edhe fajin, të paktën, gjysmën e fajit e mban vetë Presidenti i Kosovës.

Kur ligji për kreun e shtetit bëhet në këtë mënyrë, paramendoni çka ndodhë me çështje të tjera dhe ne na vjen keq, si Grup Parlamentar, seriozisht na vjen shumë keq çka po ndodhë me Kosovën, çfarë vendi jemi duke ndërtuar ne? Çka ndodhi më përpara, çka ndodh sot? Kosova, për çdo ditë e ka nga një skandal dhe me të vërtetë duhet filluar secili të rishqyrtojë vetveten, kokën e vet, të shoh çka po ndodhë me këtë vend kështu.

Na vjen shumë keq që po vijmë në këso situata për çdo ditë në Kosovë. Aq më keq, kur prej foltores së Kuvendit dëgjojmë udhëheqës institucional të Kosovës të cilët e akuzojnë opozitën. Opozita më së paku ka faj për çka po ndodhë këtu. Opozita është duke e tërhequr vërejtjen çka ka ndodhë dje dhe çka po ndodhë sot. Krejt këto çka po ndodhin, po ndodhin për shkak të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk do të hyjë tash në debat tjetër, pos asaj që e respekton kërkesën sipas procedurës që e paraqiti Kryeministri. As dje nuk ka pasur arsye që ky të

dalë jashtë procedurës. Unë e kuptoj se ju e keni mbështetur mocionin e shefave, disa shefave të grupeve parlamentare, por u sqarua ajo që është dashur të sqarohet.

Ardhja e këtij ligji, thuhet, për Presidentin e Republikës, nuk përmendet emri. Presidenti i Republikës dihet kush është sot. Presidenti i Republikës është ditur kush ka qenë dje – Presidenti historik i vendit dhe presidenti i ardhshëm sigurisht se nuk dihet, por dikush vjen pastaj. Ky ligj i rregullon të drejtat dhe privilegjet e Presidentit të Republikës së shtetit, e jo të emrit e të mbiemrit dhe nuk di pse duhet të shqetësohet dikush sot dhe të bëjë me gisht pse po ardhka dhe ky vend po e rregullon të drejtën dhe privilegjet e presidentit dhe të ish-presidentit, sepse edhe ai status rregullohet, dhe sigurisht plotëson legjislacionin për atë që duhet të plotësohet si nevojë e domosdoshme. Nuk ka kushte dhe LDK-ja është..., është edhe Kryeministri këtu, shef i Partisë që udhëheq edhe qeverisjen, edhe partinë e tij. LDK-ja në asnjë vendim nuk ka sjellë asnjë kusht, nuk e ka kulturë politike dhe nuk vazhdon në asnjë formë të jetë pjesë e presioneve të tilla që e kushtëzojnë mënyrën e punës. Ne jemi partnerë. Punojmë mbi bazë të partneritetit, i harmonizojmë qëndrimet, i harmonizojmë angazhimet tona dhe besoj se duhet këtë ta mirëkuptoni. Diçka tjetër, e kuptoj, është parlamentare, absolutisht. Ka të drejtë secili ta thotë qëndrimin e vet, por Grupi Parlamentar i LDK-së e çmon rikthimin në agjendë të sotme të këtij ligji dhe me votim besoj sot do ta përmbyllim këtë sezon pune si Kuvend dhe këtë vit historik të punës sonë në mënyrën më të denjë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Një sqarim jam i obliguar ta bëj. Për Ligjin që e kemi miratuar para kësaj seance, nuk është duke u bërë pazar me atë ligj. Ai ligj është votuar dhe s'ka nevojë të bëhet pazar mbi bazën e atij ligji. Të jeni të sigurt, se ai shkon edhe pa nënshkruar.

(Ndërhyrje – pa kyçje)

Seanca ka vendosur, prandaj ju lutem! Kanë të drejtë njerëzit t'iu bien pishman fjalëve të veta. Adem Salihaj e ka fjalën!

ADEM SALIHAI: Të nderuar kolegë deputetë,

Unë pajtohem me Kryetarin e Kuvendit, njerëzit kanë të drejtë t'i hanë fjalët e veta, natyrisht. Dje ka qenë një propozim prej shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së që të hiqet nga rendi i ditës dhe sot, i njëjti Grup Parlamentar, ose të njëjtit deputetë kërkojnë që të futet në rend dite dhe mua s'më duket në rregull në aspektin moral kjo. Po, siç tha Kryetari, keni të drejtë t'i hani fjalët tuaja.

Kur dëgjova në korridor se do të mbahet një seancë urgjente pas asaj që patëm, unë dola jashtë dhe shikova mos ka tanke, helmeta a njësi speciale, nuk dita çka po ndodhë kaq urgjentisht dhe e pyeta veten, a jemi afër të 99-tës apo në të 89-tën, diçka e çuditshme që po ndodhë këtu. Por, megjithatë, siç thamë, secili ka të drejtë, dje të marrë një vendim, sot një vendim tjetër, por s'është korrekte prej Grupit Parlamentar të PDK-së që, në njëfarë mënyre, na ka vënë në lojë të gjithë ne të tjerëve.

Sa i përket Ligjit për Presidentin, ne e kishim moti në procedurë. E kishim edhe Ligjin për deputetët dhe njëri vjen, tjetri s'vjen. Të dytë kanë të bëjnë me privilegje dhe të drejtat dhe, natyrisht, Presidenti brengoset shumë për privilegjet e tij, por nuk brengoset pse hyjnë nga 3 trena në ditë prej Serbisë, nuk brengoset që 30% të territorit e kontrollon Serbia dhe po të shkojë edhe gjysma e Kosovës nuk brengoset, po brengoset për ligjin, për privilegjet e tij dhe ndoshta edhe kjo është e arsyeshme, edhe kjo morale, por në fund mendoj se të gjitha këto s'janë në rregull dhe mendoj se të gjithë deputetët, pa përjashtim, edhe PDK, edhe LDK dhe tjerët nuk është në rregull të bëjmë një lojë me autoritetet tona si deputetë, dje ndryshe, e sot ndryshe. Dhe, mendoj se nuk është mirë të vazhdojmë në këtë mënyrë.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje, zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra,
Të nderuar deputetë,

Pa dashur të komentoj ato që i dëgjuam që, në fakt, ne jemi edhe ashtu subjekt i ri dhe përball detyrimit që kemi si konstitucionalistë, mendoj që Ligji që sot po e diskutojmë dhe që dje e hoqëm, është një prej ligjeve të rëndësishëm, që e plotëson infrastrukturën e domosdoshme ligjore për funksionimin e shtetit të Kosovës. Jemi në favor që të diskutohet ky ligj dhe që të mos prolongohet, por sigurisht mendoj që i kemi bërë dy shkelje të vogla procedurale, të cilat nuk mundemi edhe pa i thënë këtu. E para, është që dje nuk kemi pasur të drejtë ta tërheqim Ligjin në lexim të dytë, për faktin se madje në ato raste vetëm sponsorizuesi mund ta tërheq ligjin, por jo ne. Në lexim të dytë votohen amendamentet ose nuk votohen. Dhe, sot, natyrisht, konsideroj që ndoshta kishte për të qenë si procedurë prapë e domosdoshme ose, së paku e nevojshme, që paraprakisht Kryesia e Kuvendit të takohet për të caktuar rendin e ditës të kësaj seance.

Më fal Kryetar, por ne u morëm vesh vetëm që të kemi seancë të re, por për rend të ditës është Kryesia përgjegjëse dhe është Rregulla 23 pika 6 e Rregullores që thotë Kryesia e krijon rendin e ditës për seancë dhe kur ai propozohet prej Kryeministrit ose dikujt tjetër, me procedurë të shpejtuar.

Pra, këto ishin dy vërejtjet tona, si Grup Parlamentar, që deshëm t'i themi, pa dashur të hyjmë në komentet që po bëhen këtu për Presidentin, që mund të jenë pjesë e inateve të mëhershme që ne s'duam të jemi pjesë e tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Është çështje që Kuvendi dje nuk e ka tërhequr, por e ka shtyrë miratimin e Ligjit. Do të thotë, kjo duhet të kihet parasysh dhe për procedurë për seancë të sotme ka vendosur Kuvendi, me shumicë votash, dhe rendi i ditës është bërë në seancë dhe mendoj se e ka këtë të drejtë seanca. Do të thotë, mendoj se procedurat janë në rregull, por mund të mos i pëlqejë dikujt, që unë e respektoj edhe atë. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar Kryetar!

Nuk është herë e parë që shkelet Rregullorja dhe në vazhdimësi gjatë tërë kohës sa jemi në këtë Parlament, në këtë mandat, janë tërhequr ligje, sepse është bërë arsyetimi pse janë tërhequr. Por, në një procedurë kaq të shkurtër, prej dhe deri sot, të bëhet ky ndryshim, ky transformim i juaj, unë nuk po di çka ka ndodhur me ju, por duhet ta sqaroni dhe së paku Parlamenti ta dijë pse ka ndodhur kjo.

Dhe, e dyta, dy herë e keni shtyrë sot seancën, pa asnjë sqarim. Përsëri, pa u mbledhur Kryesia fare, pa u aprovuar rendi i ditës tash, ju e qitni Ligjin për Presidentin e Kosovës.

Keni kujdes në procedura, sepse nëse ju e shkelni Rregulloren, kush do ta aprovojë ose kush do të jetë ai që do ta ketë parasysh moshkeljen e saj, nëse ju të parët e bëni këtë. Dhe, është mirë që t'i përfillni procedurat, të ecni ashtu si duhet dhe të mos e bëni Parlamentin një teatër çfarë nuk i takon Parlamentit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Unë mendoj se ti je anëtar i Komisionit, kryetar i Komisionit për Rregullore dhe duhet ta dish që Rregullorja nuk është shkelur dhe është mirë, është mirë ta bëni një kërkesë me shkrim që ta shohim ne ku e kemi shkelur Rregulloren. Bëni me shkrim kërkesën. Shikoni, është Rregullorja, lexonjeni atë dhe bëni ankesë me shkrim se është shkelur kjo rregull, kjo rregull dhe nuk kemi pasur të drejtë. Ju lutem, shfrytëzoheni edhe këtë të drejtë.

(Ndërhyrje pa kyçje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Ju lutem! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në realitet, ushtrues i detyrës së Kryetarit të Kuvendit,

I nderuari ushtrues i detyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe e kemi një zëdhënës të institucioneve - ushtrues i detyrës të Kryetarit të Kosovës, për të cilin edhe shantazhet në mes të koalicionit dhe uljen e pazarit të vendit që po e bëni në kontinuitet, fyerjen e të zgjedhurit të popullit të deputetit, fyerjen e këtij Parlamenti të nderuar. Ju lutem, ne jemi Republikë Parlamentare dhe thirrja e seancës me urgjencë, bëhet vetëm në raste urgjente. Kryeministri, mos paska kërkuar thirrjen e kësaj seance sepse nuk po ia nënshkruan buxhetin Kryetari i Kosovës?! Ju lutem, ju lutem, e keni ulur pazarin e Kosovës. Kosova nuk ka institucione dhe kjo po dëshmohej çdo ditë dhe mos na vëni në sprovë, zotëri Kryetar, po ju them tani kryetar për respektin se jeni zgjedhur.

Partia më e madhe shumicë, dhe vendosi diçka tjetër me propozim të Grupit Parlamentar. Nuk keni pasur të drejtë ta tërhiqni ligjin dhe tani bëni skena të tilla që po e fyeri qytetarin e Kosovës që na ka sjellë këtu dhe po e degradoni institucionin e Parlamentit, edhe të Kryetarit të Kosovës, edhe Qeverinë para miqve tanë dhe, çka të them tjetër, ishalla Zoti na ndihmon!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri Kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë të respektuar,

Nuk ka dyshim se dje nuk bëmë mirë, mirëpo esencialisht mendoj që interpretimet duhet të bëhen elastike edhe fleksibile dhe me qëllimin e mirë, do më thënë, bona fidej.

Fjala është për dje, është shtyrë. Sot, Kryeministri ka propozuar, që ka të drejtë, Kuvendi e miratoi deshëm nuk deshëm, na pëlqeu, s'na pëlqeu, kjo çështje është e kryere tash në rend dite.

Unë, do t'i kisha theksuar dy-tri rrethana. Një, Kushtetuta që është në fuqi, edhe Ligji që është propozuar si propozim, në esencë ky ligj është në konformitet me Kushtetutën, aq më parë kur këtë ligj e ka trajtuar një nga komisionet më serioze, më kompetente, në të vërtetë më kompetenti Komision për Legjislacion dhe i ka dhënë disa amendamente.

Duke marrë parasysh faktin e padiskutueshëm se Kosova ndodhet në një situatë me plotë sfida aktuale dhe akute, unë angazhohem që ta procedojmë këtë Projektligj, se në substancë ky e ka mbështetjen në Kushtetutë, do të thotë, nuk ka diskrepancë, prandaj edhe sikundër mos të miratohej ky dokument, është Kushtetuta që i parasheh këto autorizime edhe ingerenca e prerogativa. Ndryshe, vetëm një pasus do të isha angazhuar kurdoherë kur do ta kisha pasur oportunitetin, që Kosova të ishte një shtet demokrat me sistem presidencial. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADA: Ju faleminderit, Kryetar!

Unë kisha kërkuar prej jush, si Kryetar i Kuvendit, si Qeveri që jeni, nëse nuk e respektoni opozitën dhe deputetët, të paktën respektoni rregullat, respektoni Kushtetutën e Kosovës, respektoni Rregulloren e Kuvendit.

Dje, në bazë të Rregullores së Kuvendit, pika 29, kam ngritur kërkesë për debat për sovranitetin dhe integritetin e Kosovës, që është çështje më urgjente, ndoshta jo për ju që jeni kapur për kolltukë dhe po mendoni që gjithçka ka filluar dhe mbaron me ju. Po, është shumë urgjente për qytetarët e Kosovës dhe, po e përsëris, Kosovën jeni duke e çuar drejt ndarjes. Prandaj, nuk ka qenë kërkesë për debat, për publik, apo qysh po e cilësoni ju, por ka qenë kërkesë se është çështje urgjente, në emër të qytetarëve të Kosovës, të cilët na kanë zgjedhur edhe na kanë sjellë këtu.

Nuk është çështje urgjente Ligji për Presidentin, jo, se nuk dimë se president i cilit territor do të jetë ky president, prandaj keni kujdes, nëse nuk e respektoni vetveten, Kosovën dhe qytetarët e saj, të paktën respektoni procedurat, se vetë i keni bërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zonja deputete, edhe ata që mendojnë me ty - ne nuk kemi lindur para tri dite në Kosovë dhe e dimë angazhimin dhe kontributin e secilit në këtë Kosovë, e dimë

kush e ka mbrojtur dhe kush e mbron dhe do ta mbrojë sovranitetin e Kosovës, prandaj kurseni pak fjalët edhe për juve.

Deputeti i fundit, është deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Kryeministër, Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

U fol shumë gjatë. Ne ishim në seancën e kaluar prezent edhe kur u votua, vetëm 4 deputetë të Kuvendit kanë votuar kundër për të mos hyrë kjo pikë në rendin e ditës. Tash nuk po di, po bëhemi shumë që po diskutojmë. Është dashur të maten, kur u votua për t'u mbajtur seanca e re, do të thotë, kemi qenë vetëm, në qoftë se ekziston procesverbali, 4 deputetë kundër për t'u futur kjo pikë në seancën e re të rendit të ditës.

Nuk po lëshohem në shkelje procedurale, sepse kanë kaluar shumë çështje kështu me urgjencë sa për t'u harmonizuar politikat edhe marrëveshjet e koalicionit qeverisës.

Mirëpo, kur lëshohemi në gjithë këtë, ne do të diskutojmë për shumë çka, mirëpo kur flasim për privilegjet, duhet t'ia lëmë vetes lakmi edhe atë që ne jemi të privilegjuar shumë edhe kur flitet për territorin e Kosovës, e them edhe unë kushtimisht ashtu, siç e thatë ju, sepse ky Kuvend dhe kjo përbërje e Kuvendit e ka shpallur Kosovën të pavarur edhe Deklaratën e pavarësisë me një territor kushtetues administrativ, me atë që e dimë si është marrëveshja, pa asnjë ndarje, dhe besoj se ky Kuvend duhet t'i dalë zot asaj dhe po flasim sikur të jemi pjesë të ndryshme të asaj Deklarate. Kështu që, fuqimisht e përshëndes edhe propozoj, zotëri Kryetar, se ma me rëndësi ka qenë të bisedohet dhe të na lejohet neve deputetëve të flasim për amendamentet e buxhetit, kur u aprovua buxheti, se sa tani për disa amendamente që janë vetëm për privilegje, kështu që na ke dhënë shumë hapësirë tani në këtë rast. Është dashur të merreni vesh si koalicion qeverisës, e jo të na qitni para aktit të kryer dhe të bisedohet me orë të tëra vetëm për një çështje të një ligji që rregullon privilegjet. Ju faleminderit shumë!

KRYTARI: Është e drejtë. Unë e kam respektuar Rregulloren dhe kam proceduar me Rregulloren. Edhe njëherë ju them, asnjëherë Rregullorja prej se e kam marrë këtë vend këtu, nuk është shkelur. Është shkelur nga ata që donë të flasin për opinion, por jo për ligje dhe për të punuar për këtë vend dhe për këtë popull.

Diskutues tjetër nuk kemi. Vazhdojmë me rendin e ditës:

-Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Pasi nuk ka kërkesë për diskutim, vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, për të votuar amendamentin e parë të Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 1

Votojmë, tash: A ka pa kartela?

“Për “ - 3. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Konstatohet se me 61 vota “për”, 8 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë, tash:

Pa kartela – “për” 3 vota, “kundër” nuk ka.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 5 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

I deputetit Emrush Xhamajli, i mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë, tash:

Pa kartela, 3 vota “për”.

Konstatohet se me 71 vota “për”, 2 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Pa kartela 3 vota “për”, “kundër” nuk ka.

Konstatohet se me 69 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr. 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Pa kartela 3 vota “për”, “kundër” dhe abstenim nuk ka. Mirë, ju faleminderit!

Konstatohet se me 71 vota “për”, 3 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tash:

Pa kartela 3 vota “për”, “kundër”, nuk ka, abstenim, nuk ka. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 67 vota “për”, 4 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tash:

Pa kartela 3 vota “për”, “kundër” nuk ka, abstenim nuk ka. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, 4 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Urdhëro Vlora, deputetja Vlora!

VLORA ÇITAKU: Do duhej të bëhej një plotësim në këtë amendament, sepse këtu thuhet që “Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati, në pajtim me nenin 18.1 të këtij ligji dhe bashkëshortja e tij”. Tash, ne nesër mund të kemi edhe femër presidente, kështu që do të duhej thënë: bashkëshorti/bashkëshortja. Këtë plotësim.

KRYEATARI: Komisioni! Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar! E mbështes propozimin e deputetes, sepse ka të drejtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nait Hasani e ka kërkuar fjalën. Për cilën amendament e ke fjalën, Nait!

NAIT HASANI: Për tetëshin.

KRYETARI: Mirë, urdhëro! Fol, urdhëro, e ke fjalën.

NAHIT HASANI: Po! I nderuari Kryetar!

Amendamenti 8 është jo i formuluar drejt. Për mua personalisht është që pasaporta diplomatike duhet të kenë tërë familja tërë jetën. Ka mundësi, diku në vende të ndryshme, të shteteve të ndryshme, të kemi këso ngjashmërie. Të paktën, duhet të ketë kufizime, ku familja të ketë pasaportë diplomatike, deri kur dhe kush?

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, kryetari i Komisionit, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Mendoj që e ka kufizimin. Ne për fëmijët kemi kërkuar që të jetë mosha 18 vjeçare dhe mendoj se kemi bërë mirë, sepse kemi shikuar edhe ligjet të cilat i kemi në rajon. Kurse, në Projektligj ka qenë për tërë jetën ta kenë. Kemi menduar që fëmijëve nuk është e drejtë që t'ju mundësohet pasaporta diplomatike ta gëzojnë tërë jetën, prandaj propozoj që të mbetet kështu si është propozuar në amendament. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Atëherë, shkojmë e votojmë amendamentin nr. 8, me propozimin që e dha deputetja Vlera Çitaku, me plotësimin.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Pa kartela 3 vota “për”, “kundër” nuk ka. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tash:

pa kartela 3 vota “për”, “kundër” nuk ka.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Kemi amendamenti 10 dhe të fundit.

Amendamenti 10

Votojmë, tash:

Pa kartela 3 vota “për”. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 68 “për”, 3 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Tani votojmë Ligjin në tërësi, me amendamentet e votuara.

Votojmë, tash:

Në sallë kemi 86 deputetë.

Pa kartela 4 vota “për”. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 69 vota “për”, 3 “kundër”, 6 abstenime, miratohet Ligji për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë, konstatohet përfundimin e punimeve të seancës së sotme plenare, me këtë dhe të sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit.

Mirupafshim në seancën e parë të Sesionit pranveror, që fillon të hënë e tretë të muajit janar 2009.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës